



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:095210
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728142

Ac.nr.3102/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj e Besnik Feka - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses KEDS me seli në Prishtinë, kundër të paditurit B.H nga fshati ,, , komuna e Gj,,, për shkak të pasurimit pa bazë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.369/19, të datës 21.01.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datën **23.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses KEDS me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.369/19, i datës 21.01.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar C.nr.369/19, të datës 21.01.2021, në pikën *I* (një) të dispozitivit e ka konsideruar të tërhequr, padinë e paditëses Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS me seli në Prishtinë ndaj të paditurit B.H me vendbanim në fshatin ,, Komuna e Gj,,, me objekt kontesti, kompenzimin e dëmit, për shkak të mos paraqitjes në gjykatë të paditëses, edhe pse e njëjta ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt me anë të ftesës, të njëjtën e ka pranuar mirëpo mungesën nuk e ka arsyetuar. Në pikën *II* (dy) të dispozitivit ka vendosur që pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi Lënda C.nr.369/19, konsiderohet e kryer dhe arkivohet nga Gjykata Themelore në Gjilan. Për zgjidhjen e çështjes kontestuese, në rast se krijohen kushtet ligjore, paditësja mund të ushtroj padi të re, në

kopje të mjaftuara, përmes kësaj gjykate. Në pikën III të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktvendimi paditësja në afatin ligjor ka parashtruar ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të: *shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur nga ana e palës së paditur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, e në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e paditëses është e pa themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datën 25.04.2019, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit për shkak të pasurimit pa bazë, me të cilën ka propozuar që të aprovet padia e paditëses ashtu që të obligohet i padituri që paditësit t'ia kthejë shumën prej 431.15 euro, më gjërësisht si në padi.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses gjykata e shkallës së parë ka filluar procedurën dhe ka caktuar seancën e radhës për datën 21.01.2021, në të cilën seancë nuk prezenton pala paditëse përkundër thirrjes së rregullt. Pas kësaj gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin e atakuar C.nr.369/19, të datës 21.01.2021 me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses.

Në arsyetimin e këtij aktvendimi gjykata ka theksuar se e ka konsideruar të tërhequr padinë, pasi që i autorizuari i paditëses ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyerjen e seancës.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjen në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe pajtohet në tërësi me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se në rastin konkret ka vepruar drejtë kur me aktvendim e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses, sepse vet paditësja i ka dhënë shkas për këtë vendosje dhe për këtë vet ajo i bartë pasojat në kuptim të ligjit, ngase i autorizuari i paditëses nuk e ka arsyetuar mungesën në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, e caktuar më datën 21.01.2021.

Paditësja, përkatësisht i autorizuari i saj, nëse nuk ka mundur që të paraqitet me kohë në seancë për shkaqe të arsyeshme, ka pasur mundësi që në kuptim të nenit 129 dhe 130 të LPK-së, të parashtronte propozim për *kthimin në gjendjen e mëparshme*, e të cilën nuk e ka bërë brenda afateve të parapara ligjore për këtë propozim, duke mos e shfrytëzuar fare këtë mundësi ligjore.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të atakuar, pati parasysh pretendimin ankimor të autorizuarit të paditëses se “*paditësja kishte njoftuar gjykatën me parashtrësë, të cilën e kishte dërguar përmes postës, e me të cilën e kishte arsyetuar mungesën*”, nga e cila ka rezultuar aktvendimi i goditur, që sipas gjykatës ky pretendim është i paqëndrueshëm dhe i pa argumentuar, për shkak se është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht nenin 437.2 të LPK-së ku parashihet se “*Gjykata ka për detyrë që, më së voni shtatë (7) ditë para fillimit të seancës, që të bëjë verifikimin nëse janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni*”, kjo për faktin se gjykata parashtrësën për shtyerje të seancës e ka pranuar vetëm së bashku me ankesën kundër vendimit ku është konsideruar e tërhequr padia me datë 11.02.2021, andaj gjykata e shkallës së parë ka vepruar në tërësi në pajtim me dispozitat e nenit 423 par.3 të LPK-së, prandaj dhe konkludimin e gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës.

Ky aktvendim nuk është përfshirë me kurrfarë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, (*të pretenduara me ankesë*), dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208 të LPK-së.

Si përfundim, aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë me të cilin është konsideruar e tërhequr padia e paditëses është i drejtë dhe i ligjshëm, e i bazuar në dispozitat ligjore të nenit 423.3 të LPK-së, ashtu që pretendimet ankimore të paditëses janë të pabazuara dhe të paargumentuara me asgjë, andaj dhe i njëjti aktvendim - vërtetohet.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3102/21, datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Arsim Hamzaj